

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6491
E premte, 17 dhjetor 2021
çmimi 0.40 €

Danimarka do të marrë me qira 300 qeli burgu të Kosovës



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", EDITA TAHIRI | FAQE 4-5

NËSE E THEMELON ASOCIACIONIN, KURTI TRADHTON ELEKTORATIN



Ish-kryenegociatorja e Kosovës për bisedime me Serbinë, Edita Tahiri, ka bërë me dije se ka ardhur koha që Kosova ta ketë një qëndrim më të qartë në raport me dialogun me Serbinë. Ajo ka thënë se ky qëndrim nënkupton ndaljen e dialogut teknik dhe fillimin e diskutimit për marrëveshjen finale. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Tahiri ka thënë se nëse kryeministri Albin Kurti do të angazhohet për zbatimin e marrëveshjes së asociacionit, ai do ta tradhtonte elektoratin e tij. Sipas saj, Kurti ka ardhur në pushtet duke krijuar kauza të rrejshme kundër formimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe

AKTUALE



GJERMANIA DËBON DY DIPLOMATË RUSË

RASTI IVANOVIQ: DËSHMITARI KONFIRMON PRANINË E GRUPEVE KRIMINALE NË VERI

TETË RASTE TË REJA ME COVID NË KOSOVË



EKONOMI



RIKTHEHET NGROHJA NGA 'TERMOKOS'-i

EDHE UJI PRITET TË SHITRENJTOHET

SPORT



MERCEDESI HEQ DORË NGA ANKESA LIGJORE KUNDËR TRIUMFIT TË VERSTAPPENIT

Gërvalla takon kryetarin e Bujanocit, flasin për pasivizimin e adresave të shqiptarëve



EURODEPUTETËT MIRATOJNË RAPORTIN: KËSHILLI I BE-së T'I LIBERALIZOJË VIZAT PËR KOSOVËN

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Franca shkurton udhëtimet nga Britania për shkak të Omicronit

PARIS, 16 DHJETOR - Franca do t'i shkurtojë udhëtimet nga Britania e Madhe për shkak të frikës nga varianti i ri i koronavirusit, "Omicron", i cili po përhapet me shpejtësi. Autoritetet franceze do të imponojnë një mori arsyesh për udhëtime dhe do të kërkojnë izolim prej së paku 48 orë për të gjithë që vijnë nga Britania e Madhe në Francë, njoftoi qeveria franceze më 16 dhjetor. "Masat e reja do të hyjnë në fuqi të dielën pas mesnate", ka deklaruar

kryeministri francez, Jean Catex. Qeveria franceze, po ashtu, do të mbajë një takim të posaçëm të sigurisë për shkak të pandemisë të premtën dhe do ta adresojë presionin në rritje ndaj spitaleve franceze për shkak të rritjes së numrit të të infektuarve javët e fundit.

"Delta" mbetet varianti dominues në Francë, ndonëse "Omicroni" po përhapet me shpejtësi në Britani sa që ngriti shqetësime edhe në Francë. Sipas zëdhënësit të qeverisë

franceze, Gabriel Attal, udhëtimet për punë apo udhëtimet turistike në Francë do të "limitohen" ndonëse qytetarët francezë do të mund të udhëtojnë.

Masat e reja në Francë do të zbatohen për persona të vaksinuar dhe të pavaksinuar. Britania e Madhe regjistroi numrin më të lartë të infektimeve me Covid-19 të mërkurën, derisa ka paralajmërimet që situata mund të përkeqësohet.



Gjermania dëbon dy diplomatë rusë

BERLIN, 16 DHJETOR - Gjermania dëboi dy diplomatë rusë pasi një gjykatë në Berlin shpalli fajtor një shtetas rus për vrasjen e një militanti çeçen më 2019 në Berlin, pas urdhrat të marrë nga Moska.

Ministria e Jashtme gjermane, Annalena Baerbock, tha më 15 dhjetor se ambasadori rus në Gjermani, Sergei Nechayev, është njoftuar për dëbimin e diplomatëve.

Përfshirja ruse në vrasjen e Tornike Kavtarashvili më 2019 ishte "shkelje e rëndë e ligjeve gjermane dhe sovranitetit të Gjermanisë", ka thënë Baerbock. Gjykata në Berlin tha se autori i vrasjes së Kavtarashvili ishte 56-vjeçari Vadim Krasikov, i njohur edhe me emrin Vadim Sokolov.

Vraja e Kavtarashvili në Berlin kishte përkeqësuar raportet në mes të Rusisë dhe Gjermanisë, por gjykata tha se vendimet e saj



nuk janë ndikuar nga raportet politike midis Berlinit dhe Moskës.

Krasikov dyshohet se është agjent i shërbimit sekret rus, FSB. Prokurorët thanë se Moska e

kishte urdhëruar vrasjen sepse Kavtarashvili, që njihej edhe si Zelimkhan Khangoshvili, ishte

komandant i separatistëve në Kaukazin Verior në periudhën ndërmjet vitit 2000 dhe 2004.

Presidenti rus Vladimir Putin e kishte cilësuar Khangoshvili si "bandit" dhe terrorist. Prokurori federal Nikolaus Förschner gjatë gjykimit argumentoi se nuk ishte e rëndësishme nëse viktimi ishte terrorist, pasi ai kishte qenë azilkërkues në Gjermani që prej vitit 2016 dhe, sipas prokurorit, Khangoshvili nuk paraqiste rrezik që do ta justifikonte vrasjen e tij.

Förschner e akuzoi udhëheqjen ruse për "shpërfillje të sundimit të ligjit" dhe shkelje të sovranitetit të Gjermanisë.

Ambasada ruse në Gjermani tha se vendimi i gjykatës ishte "i motivuar politikisht" dhe ky vendim do t'i komplikojë edhe më shumë raportet në mes të Rusisë dhe Gjermanisë.

Tërhiqet plani i paraparë për minierën e litiumit në Serbi

Beograd, 16 dhjetor - Kuvendi Komunal i Lloznicës solli më 16 dhjetor vendimin për ndërprerjen e planit hapësor të këtij qytetit në perëndim të Serbisë. Me këtë plan parashihej ndërtimi i minierës së litiumit të kompanisë "Rio Tinto".

"Rio Tinto" renditet si kompania e gjashtë në botë për metale e miniera. Fjala është për një kompani multinacionale britaniko-australiane, me seli në Londër, e cila operon në 35 shtete të botës.

Në seancën urgjente të thirrur nga Kuvendi Komunal, 46 asamblistë votuan për ndërprerje të planit, askush nuk ishte kundër dhe 13 asamblistë nuk morën

pjesë në votim. Qytetarët serbë protestuan të hënën e 29 nëntorit në këtë qytet para Kuvendit Komunal duke kërkuar tërheqjen e planit hapësor, me të cilin parashihej ndërtimi i minierës. Peticionin kundër planit në këtë zonë e nënshkruan më shumë se 5 000 njerëz nga rreth 80 mijë banorë.

Banorët lokalë të mbledhur në shoqata të ndryshme, organizata lokale, një pjesë e ekspertëve dhe shumë parti opozitare, konsideronin që miniera do të mund të kishte pasoja negative ndaj mjedisit jo vetëm në perëndim të Serbisë, por edhe më larg.

Protestën e organizoi një shoqatë

lokale ekologjike e qytetarëve që kundërshtonte ndërtimin e minierës së regjistruar në këtë zonë.

Paralajmërimi për ndërtimin e minierës së litiumit të kompanisë "Rio Tinto", krahas Ligjit për Shpronësim dhe Ligjit për Referendume, ishin faktorë që nxitën një valë protestash të disa organizatave ekologjike kah fundi i nëntorit dhe në fillim të dhjetorit për dy fundjavë rresht. Protestuesit bllokuan rrugët e trafikut ndërkombëtar në disa pjesë të Serbisë.

Më 8 dhjetor Qeveria e Serbisë tërhoqi Ligjin për Shpronësim e përgjatë votimit në Kuvend më 10 dhjetor e plotësoi Ligjin për



Referendume. "Rio Tinto" ka mohuar akuzat e aktivistëve për dëme potenciale në mjedis dhe theksoi se projekti

do të realizohet në "përputhje me rregulloret ligjore të Serbisë, atë të Bashkimit Evropian dhe standardeve të vet kompanisë".

Eurodeputetët miratojnë raportin: Këshilli i BE-së t'i liberalizojë vizat për Kosovën

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

BRUKSEL, 16 DHJETOR - Komisioni i Punëve të Jashtme i Parlamentit Evropian ka miratuar raportin për adresimin e krimit të organizuar në Ballkanin Perëndimor dhe nevojën që BE-ja ta përshpejtojë procesin e integritetit. Në raport deputetët e Parlamentit

Evropian kanë kërkuar liberalizimin e vizave për Kosovën nga Këshilli i BE-së sipas tyre, izolimi shton aktivitetet kriminale. Ky raport është miratuar me 531 vota për, 48 kundër dhe 117 abstenime. "Raporti, i miratuar të mërkurën në mbledhje me 531 vota për, 48 kundër dhe 117 abstenime, thotë se vendet e Ballkanit Perëndimor janë vendet e origjinës,

destinacionit dhe tranzitit për trafikimin e qenieve njerëzore dhe ato shërbejnë si një korridor tranziti për migrantët dhe refugjatët dhe si një vend për pastrim parash dhe trafik armësh. Megjithatë, eurodeputetët theksojnë se lufta kundër krimit të organizuar dhe integrimi në BE janë procese reciproke përforcuese, duke i kërkuar BE-së ta përshpejtojë

procesin e integritetit. Në këtë kontekst, pasi izolimi inkurajon aktivitetet kriminale, eurodeputetët gjithashtu i bëjnë thirrje Këshillit që ta miratojë liberalizimin e vizave për Kosovën pa vonesa të mëtejshme", thuhet në raport. Sipas raportit, popujt e Ballkanit janë të ekspozuar ndaj korrupsionit dhe mungesës së punësimit. "Faktorët kryesorë që i bëjnë

shoqëritë e Ballkanit Perëndimor të ekspozuara, thotë raporti, janë mungesa e mundësive të punësimit, korrupsioni, dezinformimi, elementët e kapjes së shtetit, pabarazia dhe ndërhyrja e huaj nga regjimet jodemokratike si Rusia dhe Kina", thuhet në komunikatën për medie të Komisionit për Punë të Jashtme të PE-së.



Gërvalla takon kryetarin e Bujanocit, flasin për pasivizimin e adresave të shqiptarëve



BUJANOC, 16 DHJETOR (ER) - Zëvendëskryeminstria dhe ministria e Punëve të Jashtme të Kosovës, Donika Gërvalla, ka realizuar të enjten vizitën e saj të parë zyrtare në Luginë të Preshevës.

Agjenda e saj filloi me takimim me kryetarin e komunës së Bujanocit, Nagip Arifi, në zyrën e këtij të fundit. Kryetari Arifi e njoftoi nga afër ministren Gërvalla rreth situatës politike, sociale dhe asaj të zhvillimit ekonomik, si dhe diskriminimit të vazhdueshëm të shqiptarëve nga organet e qeverisë qendrore në Beograd në fushat e arsimit, ekonomisë, shëndetësisë. Me theks të veçantë ishte çështja e pasivizimit të adresave të

shqiptarëve në Luginë, si dhe mosnjohja e diplomave të marra nga universitetet e Republikës së Kosovës. Në fund të takimit, Gërvalla dhe Arifi u pajtuan që ta vazhdojnë bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve politike deri në gjetjen e zgjidhjes së problemeve. Ministria Gërvalla ka vazhduar takimim me kryetarin e Kuvendit Komunal të Bujanocit, Enver Ramadani, më pas është takuar edhe me kryetarin e KKSh-së, Ragmi Mustafa. Ministria Gërvalla ka qëndruar edhe në Preshevë, ku ka realizuar takime të ndara me kryetaren e komunës së Preshevës, Ardita Sinani, dhe me kryetarin e APN-së, Shqiprim Arifi.

Krasniqi në Skenderaj: Rikthimi i PDK-së është garanci për zhvillim

SKENDERAJ, 16 DHJETOR (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka qëndruar të enjten në Skenderaj, ndërsa ka thënë se rikthimi i PDK-së në udhëheqjen komunale në Skenderaj është garanci për fillimin e një modeli qeverisës zhvillimor dhe transformues dhe me perspektivë për të

gjithë. Krasniqi në një postim në "Facebook" ka shkruar se ka takuar kryetarin e kësaj komune, Fadil Nura, me të cilin kanë biseduar për planifikimin e projekteve. "Kryetarin Nura dhe ekipin e tij, të cilët veçse kanë filluar të punojnë për përmirësimin e shërbimeve publike dhe po

planifikojnë zbatimin e projekteve të rëndësishme, i përgëzoja për vendosmërinë dhe angazhimin për jetësimin e programit të tyre. Mirënjohës ndaj qytetarëve të Skenderajt që treguan se PDK-ja është në zemrën e Skenderajt, përherë unike dhe e pandashme", ka shkruar Krasniqi.





FLET PËR "EPOKËN E RE", EDITA TAHIRI

Nëse e themelon asociacionin, Kurti tradhton elektoratin

Ish-kryenegociatorja e Kosovës për bisedime me Serbinë, Edita Tahiri, ka bërë me dije se ka ardhur koha që Kosova ta ketë një qëndrim më të qartë në raport me dialogun me Serbinë. Ajo ka thënë se ky qëndrim nënkupton ndaljen e dialogut teknik dhe fillimin e diskutimit për marrëveshjen finale. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Tahiri ka thënë se nëse kryeministri Albin Kurti do të angazhohet për zbatimin e marrëveshjes së asociacionit, ai do ta tradhtonte elektoratin e tij. Sipas saj, Kurti ka ardhur në pushtet duke krijuar kauza të rrejshme kundër formimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

Prishtinë, 16 dhjetor -

"Epoka e re": Znj. Tahiri, në këtë mandat qeverisës janë zhvilluar disa takime të nivelit të lartë dhe të nivelit teknik në mes të Kosovës dhe Serbisë. Cili është vlerësimi juaj për qasjen e qeverisë Kurti ndaj këtij procesi?

Tahiri: Prej vitit 2017 kur qeveria jonë ka përfunduar mandatin, dialogu në mes të

Kosovës dhe Serbisë po shkon shumë ngadalë. Në tre vjetët në vazhdim dialogu më shumë ka pushuar sesa që ka pasur rezultate. Këtë vit kemi parë disa takime të nivelit të lartë politik dhe teknik, por nuk po shohim përparim. Mendoj se ka ardhur koha që Kosova ta ketë një qëndrim më të qartë në raport me këtë dialog.

"Epoka e re": Çfarë nënkupton qëndrimi më i qartë?

Tahiri: Kosova duhet ta bëjë të

qartë se nuk ka më bisedime teknike me Serbinë, siç janë bërë bisedat për targa, e gjëra të tjera. Kosova duhet të kërkojë nga Uashingtoni dhe Brukseli që të fillojë menjëherë dialogu final për një marrëveshje përfundimtare e cila do ta përfshinte njohjen reciproke në kufijtë aktualë. Ndërsa marrëveshjet e këtij procesi që nuk janë zbatuar të hyjnë në kuadër të marrëveshjes përfundimtare. Shumica e këtyre marrëveshjeve janë zbatuar, por ka disa marrëveshje nga të dyja palët që nuk janë zbatuar. Humbja e kohës me biseda teknike vetëm sa po i jep mundësi BE-së si ndërmjetësuese të pretendojë se gjoja është duke bërë një aktivitet, ndërsa realisht nuk ka ndonjë përparim.

Gjithashtu, duhet të kihet parasysh se tani është përfshirë në lojërat gjeopolitike edhe Rusia. Kjo duhet të jetë shumë brengosëse, sepse Serbia e

ndihmuar nga Rusia ka arritur ta destabilizojë përsëri Bosnjën dhe Hercegovinën. Po ashtu, ka destabilizuar Malin e Zi dhe po përpiqet ta destabilizojë Kosovën, duke e mbajtur ushtrinë afër kufirit të Kosovës. Këto lojëra të mëdha gjeopolitike kërkojnë urgjentisht ndërhyrjen e partnerëve perëndimorë: ShBA-së, BE-së, Gjermanisë dhe Britanisë së Madhe. Nëse nuk ndalen Rusia dhe Serbia, po frikësohem se ndikimi rus mund të krijojë një realitet të hidhur të kufijve të ri gjeopolitikë që përcaktojnë influencat e fuqive të mëdha. Ballkani Perëndimor dhe Kosova është përcaktuar për sferën e influencës së Perëndimit. Pra, nuk duhet të lejohet Serbia ta sjellë Rusinë në Ballkan. Në këtë kuadër, është edhe kjo iniciativa rajonale 'Ballkani i hapur' që është një projekt negativ, i cili po shërben për ta krijuar Serbinë e madhe.

"Epoka e re": Në konferencën e përbashkët për medie pas mbledhjes së fundit të Këshillit Stabilizim Asociacionit, përfaqësuesi i lartë për politikë të jashtme të BE-së, Josep Borrell, ka shprehur mospajtim me kryeministrin Albin Kurti sa i përket obligimit të Kosovës për themelimin e Asociacionit. Si e keni parë këtë qëndrim të BE-së?

Tahiri: Qeveria Kurti ka ardhur në pushtet duke krijuar kauza të rrejshme kundër formimit të asociacionit dhe kundër demarkacionit me Malin e Zi. Së pari nëse kjo qeveri dhe Albin Kurti zbatojnë marrëveshjen e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, atëherë tradhton votuesit e vet. Së dyti, natyrisht se kjo qeveri ka obligime ndërkombëtare. Ne kemi parë se kjo qeveri arriti ta anulojë marrëveshjen e Uashingtonit në Kuvend, pastaj e anuloi projektin për gazsjellësin amerikan. Këto veprime lënë shumë dyshime për orientimin e kësaj qeverie.

Rasti Ivanoviq: Dëshmitari konfirmon praninë e grupeve kriminale në veri

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Në Gjykatën Themelore në Prishtinë, më 16 dhjetor, ka vazhduar gjykimi lidhur me vrasjen e politikanit opozitar serb, njëherësh lider i Iniciativës Qytetare "Liri, Demokraci, Drejtësi" (GI, SDP), Oliver Ivanoviq.

Në seancën e së enjtes u dëgjua dëshmitari Ç. I.

Ç. I., pjesëtar i Policisë së Kosovës, deklaroi se Oliver Ivanoviqi, të cilin e kishte mik, ndihej i rrezikuar pak para vrasjes.

Ivanoviqi, madje, sipas dëshmitarit, para se të vritej, u ishte drejtuar edhe organeve përgjegjëse në Kosovë e Serbi.

Sipas pohimeve të avokatit mbrojtës, dëshmitari Ç. I. konfirmoi që në veri të Kosovës ekzistojnë grupe kriminale, por nuk ia doli të saktësonte se kush është udhëheqësi i tyre. Për këtë temë dëshmitari nuk dëshoi të fliste për shkaqe sigurie.

Prokuroria Speciale e Kosovës deri më tani ka ngritur tri aktakuza, në të cilat nuk kishte ndryshime të mëdha esenciale. Aktakuzë u ngrit kundër Nedelko Spasojeviq (zyrtar policor), Marko Roshiq (qytetar i Mitrovicës së Veriut), Sillvana Arsiq (ish-sekretare e të vërit Ivanoviq), Dragisha Markoviq (zyrtar policor), Zharko

Jovanoviq (zyrtar policor) dhe Rade Basara (zyrtar policor).

Me këtë vrasje ndërlidhen edhe Zhelko Bojiq (shef i operativës i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut), Millan Radoiçiq (nënkryetar i subjektit politik Lista Serbe) dhe Zvonko Vesellinoviç (biznesmen). Kundër tyre, megjithatë, nuk u ngrit aktakuzë, sepse ishin në arrati kur Prokuroria e Kosovës ngriti aktakuzën e parë.

Radoiçiq dhe Vesellinoviç në aktakuzë përmenden si "udhëheqës të grupit kriminal", i cili planifikoi vrasjen e politikanit serb Ivanoviq.

Megjithatë, për Millan Radoiçiqin në mars të këtij viti u tërhoq urdhri për arrestim pa kurrfarë shpjegimi dhe që nga ajo kohë ai disa herë qëndroi në veri të Kosovës.

"Dëshmitari tentoi ta bindë gjykatën se i ndjeri Ivanoviq e luste t'ia dërgonte fotografitë dhe informatat për persona të caktuar. Unë mund të them që ai në njëfarë forme e tradhtoi shërbimin e vet, sepse këto veprimtari nuk lejohen", tha para gazetarëve Mahmut Halimi, avokat i të akuzuarit Marko Roshiq.

Të gjithë të akuzuarit në rastin e vrasjes së Ivanoviqit më herët ishin deklaruar të pafajshëm për aktakuzat me të cilat



ngarkohen.

Oliver Ivanoviq, lider i SDP-së, u vra më 16 janar 2018 para selisë së partisë së tij në Mitrovicën e Veriut.

Millan Radoiçiq dhe Zvonko Vesellinoviç ndodhen tashmë në listën e sanksioneve nga Departamenti i Thesarit të ShBA-së për shkak "të

përfshirjes në rrjete korruptive me krimin e organizuar ndërkombëtar".

Sanksionet vlejné edhe për 10 persona të tjerë, serbë nga veriu i Kosovës, që janë të ndërlidhur me Vesellinoviçin, të cilin ShBA-ja e përmend si udhëheqës i grupit kriminal. Në mesin e tyre janë edhe Zhelko Bojiq, emri i të

cilit ndërlidhet me vrasjen e Ivanoviqit dhe Marko Roshiq, i cili është një prej të akuzuarve në këtë rast. Sanksionet e ShBA-së nënkuptojnë që pronat e individëve, të cilët ndodhën në listën e zezë, do të bllokohen derisa shtetasve amerikanë u ndalohet bashkëpunimi me ta. (rel)

Tani kjo qeveri nuk bashkëpunon në raport me asociacionin. Unë nuk i jap këshilla kësaj qeverie, por mendoj se në raport me aleatët perëndimorë kjo qeveri duhet të mendojë thellë. Kosova si shtet është i suksesshëm vetëm kur ka politika të brendshme funksionale dhe politika të jashtme funksionale, të cilat forcojnë marrëdhëniet me aleatët strategjikë. Këtu kam parasysh ShBA-në, Gjermaninë, BE-në, NATO-n etj.

"Epoka e re": Sipas jush, cila duhet të jetë qasja e kësaj qeverie ndaj asociacionit të komunave me shumicë serbe?

Tahiri: Nuk e këshilloj për asgjë këtë qeveri. Në kohën kur unë kam qenë kryenegociatore, pra gjatë qeverisë Thaçi dhe qeverisë Mustafa, praktikisht kemi bashkëpunuar në këtë temë. Asociacioni nuk ka lindur në Bruksel. Ai ka lindur në bisedimet për marrëveshjen e Vjenës. Pra, me Planin e Ahtisarit delegacioni i Kosovës ka pranuar që në Kosovë mund të ketë më shumë se një asociacion. Pastaj Ligji për Vetëqeverisje Lokale në Kosovë e thekson këtë. Edhe në takimet që kemi pasur në Bruksel dhe

Uashington na kanë thënë se këtë e keni në ligjet e juaja. Tani i takon kësaj qeverie të vendosë se çfarë dëshiron të bëjë. Nëse nuk i zbaton obligimet ndërkombëtare mund të ketë pasoja kjo qeveri.

"Epoka e re": Së fundi edhe përfaqësuesit e ShBA-së kanë kërkuar rezultate konkrete në procesin e dialogut, duke kërkuar zbatimin e marrëveshjes për Asociacionin. Mosdëgjimi i këtyre kërkesave mund ta izolojë Kosovën?

Tahiri: Kryeministri Kurti duhet të udhëtojë në ShBA. E di që ka vështirësi ta bëjë këtë gjë, por duhet të gjejë mënyrë për ta realizuar një vizitë të tillë. Pra, ai duhet të shkojë në Uashington dhe të takohet me zyrtarët më të lartë amerikanë për të kërkuar që dialogu të ndërmjetësohet nga ShBA-ja dhe BE-ja. Nuk mjafton vetëm fuqia e BE-së për ta shtyrë drejt finales dialogun. Ka ardhur koha që të bashkohet blloku euro-amerikan për të finalizuar këtë proces. Kryeministri Kurti duhet të kërkojë që marrëveshja të finalizohet me njohje reciproke duke propozuar që marrëveshjet e pazbatuara të hyjnë në kuadër të



marrëveshjes së përgjithshme dhe t'i ndalë bisedimet teknike që po i shërbejnë Serbisë për të blerë kohë për ta bërë Serbinë e madhe.

"Epoka e re": Në mbledhjen e fundit të Këshillit të Stabilizim Asociimit në Bruksel, Kosova u përfaqësua me fusnotë. Z. Kurti dhe partia e tij ju kanë kritikuar juve për arritjen e marrëveshjes së fusnotës. Keni ndonjë vlerësim për këtë përfaqësim?

Tahiri: Ky është një tregues se Kurti po e sheh realitetin. Dhe

realiteti është se pesë vendet anëtare të BE-së ende nuk e kanë njohur Kosovën. Fusnota është një mekanizëm në mënyrë që Kosova të mos mbetet e izoluar. Nëse kryeministri do ta refuzonte këtë fusnotë, ai do të mund të rrinte në shtëpi. Në këtë mënyrë do ta izolonte edhe Kosovën. Kjo fusnotë nuk është bërë prej dëshirës, por për shkak të mosnjohjes së Kosovës nga këto pesë vende. Të gjithë e dimë se Kosova nuk është anëtare e OKB-së dhe krejt dokumentet e OKB-së për Kosovën janë me

fusnotë prej vitit 1999 sepse ne nuk arritëm që ta kompletojmë njohjen e të gjitha shteteve. Kjo qeveri një prej pikave strategjike duhet ta ketë lobizimin për njohjen nga këto pesë vende. Mirëpo, ajo që po shoh nga Ministria e Jashtme e Kosovës është se është e tëra në defanzivë. Ajo është në një gjumë dimëror dhe gjatë këtyre tetë muajve nuk kam parë ndonjë aktivitet lobues te këto pesë shtete.

E kam thënë atëherë se fusnota do të shkrihet me njohjen nga këto pesë vendet e BE-së. Qeveria duhet të angazhohet për këtë punë. Të krijojë grupe strategjike lobuese në kryeqendrat e Spanjës, Rumanisë, Greqisë, Sllovakisë dhe Qipros.

Gjithashtu, Kosova ka hyrë në rrugën zyrtare të integritimeve evropiane, duke nënshkruar MSA-në në vitin 2016. Kjo ka ndodhur me marrëveshjen për fusnotën, sepse këto pesë vende nuk e kanë bllokuar integritimin evropian të Kosovës. Ne si udhëheqje e Kosovës nuk e lejuam izolimin e Kosovës, por e hapëm rrugën që Kosova të jetë në rrugën zyrtare të integritimit evropian me nënshkrimin e MSA-së.

ShBA-ja e përkrah QKUK-në edhe me një donacion

PRISHTINË, 16 DHJETOR (ER) - Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) në vazhdimësi përmes Zyrës për Bashkëpunim dhe Mbrojtje pranë Ambasadës Amerikane e kanë përkrahur me donacione Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Donacioni i fundit është dorëzuar ditën e djeshme dhe përmban pajisje mjekësore të dedikuara për të sëmurët me Covid-19 në vlerë prej 520 mijë dollarësh. Donacionin e dorëzoi Nick Giacobbe, i ngarkuar me punë në Ambasadën Amerikane dhe majori Conley, shef i Zyrës për Bashkëpunim dhe Mbrojtje në Ambasadën Amerikane. Për donacionin e dhuruar i falënderoi ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, kryesuesja e bordit drejtues të ShSKUK-së, Agreta Gashi dhe drejtori i përgjithshëm i ShSKUK-

së, Valbon Krasniqi. Ata e falënderuan ShBA-në për kontributin e vazhdueshëm dhënë institucioneve shëndetësore të Kosovës. Drejtori Krasniqi, bashkë me ministrin Latifi, dhuruan një mirënjohje për Zyrën për Bashkëpunim dhe Mbrojtje, duke vlerësuar donacionet që janë dhënë në vazhdimësi për ShSKUK-në. ShBA ka ndihmuar edhe rinovimin e lavatores së QKUK-së, Klinikës së Pediatrisë, dhe ka dhuruar pajisje mjekësore gjatë tri valëve të pandemisë Covid-19. Dhurimin e kontejnerëve për mbetje spitalore, pajisje me laparoskopë për Klinikën e Kirurgjisë Abdominale, CT për Spitalin e Gjakovës. Së fundmi, ShBA po kontribuon edhe për rinovimin e Kuzhinës Qendrore në QKUK.



Komandanti i FSK-së pranon urim nga ministri i Mbrojtjes i Turqisë



Prishtinë, 16 dhjetor (ER) - Komandanti i FSK-së, gjeneralletjënant Bashkim Jashari, ka pritur kolonel Çağdas Akif Kahraman. Me këtë rast, kolonel Kahraman, në emër të ministrit të Mbrojtjes së Turqisë, Hulusi Akar, ka urreuar gjeneral Jasharin për marrjen e detyrës së re në pozitën e komandantit të FSK-së dhe në mënyrë simbolike i ka dhuruar një pllakë. Në emër të ministrit Akar, kolonel Kahraman ka theksuar se Turqia, si një vend mik dhe aleat i fuqishëm i Kosovës, sikur

deri më tash, do të vazhdojë ta ndihmojë dhe mbështesë FSK-në në të gjitha fushat dhe komponentët, në mënyrë që t'i përmbushë me sukses të plotë synimet e saj. Gjithashtu, në këtë takim gjeneral Jashari ka pranuar letër urimi nga shefi i stafit të përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Turqisë, gjeneral Yasar Guler, për emërimin e komandantit të FSK-së, duke shprehur gatishmërinë për thellimin e mëtejme të bashkëpunimit ushtarak në mes të forcave të të dyja vendeve.

Besnik Boletini zgjedhet kryetar i bordit të RTK-së

PRISHTINË, 16 DHJETOR (ER) - Bordi i Radio Televizionit të Kosovës ka mbajtur mbledhjen e parë konstitutive në të cilën kanë marrë pjesë dhjetë anëtarë. Në këtë mbledhje përmes votimit të fshehtë bordi ka zgjedhur kryetarin dhe nënkryetaren. Me shtatë vota për, kryetar i bordit është zgjedhur Besnik Boletini. Gjithashtu, me shtatë vota për Arta Berisha është zgjedhur nënkryetare.

Në këtë mbledhje bordi ka diskutuar lidhur me gjendjen aktuale të RTK-së. Me propozimin e kryetarit, bordi ka adresuar një kërkesë të menaxhmeti i RTK-së për të marrë të dhëna të hollësishme mbi gjendjen e RTK-së në aspekte të veçanta në një afat të caktuar. "Të dhënat sipas kontratës, për secilin punëtor sipas njësive; kontratat për shërbime dhe ato mbi vepër për

të gjithë punëtorët; kohën kur ato kanë filluar dhe kur përfundojnë; kontratat që RTK i ka aktualisht me produksionet e jashtme dhe mënyrën e pagesës; listën e borxheve që i ka RTK-ja ndaj secilit subjekt; raportin financiar të marketingut, ku përfshihen të gjitha kontratat e marketingut që aktualisht i ka RTK-ja", është bërë me dije në njoftimin për medie të bordit të RTK-së.



Ministri Latifi javën e ardhshme e viziton Shqipërinë

PRISHTINË, 16 DHJETOR (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, ka zhvilluar një takim me ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi. Në këtë takim është biseduar për

bashkëpunimin midis dy shteteve në shëndetësi, për përkrahjen e ndërsjellë për ballafaqimin me Covid-19 dhe për avancimin e shërbimeve shëndetësore. Ministri Latifi ka pranuar edhe ftesën që

javën tjetër të realizojë një vizitë në Tiranë për të diskutuar me homologen Ogerta Manastirliu për sfidat aktuale të shëndetësisë në dy shtetet dhe bashkëpunimin e mëtejme.



Danimarka do të marrë me qira 300 qeli burgu të Kosovës

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Ministria e Drejtësisë ka njoftuar se janë pajtuar për një marrëveshje me institucionet e Mbretërisë së Danimarkës, respektivisht Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Bashkëpunimit Zhvillimor për lirim të një institucioni korrektues me kapacitet për 300 të dënuar.

Ministria e Drejtësisë zotohet për lirim të një institucioni korrektues me kapacitet për 300 të dënuar, të cilët do të sillen nga Mbretëria e Danimarkës.

Të dënuarit të cilët do të transferohen në këtë institucion nuk do të jenë të rrezikshëm të së lartë.

Si kompensim për këtë, Republika e Kosovës përfiton 210 milionë euro, të cilat do të dedikohen edhe në investime kapitale, në veçanti për energjinë e ripërtërishme.


Nga ky kompensim do të përfitojnë në masë të madhe edhe institucionet e drejtësisë, po ashtu edhe Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndaj të cilit do të ndikojë në ngritjen e cilësisë dhe infrastrukturës së

përgjithshme të këtij shërbimi.

“Theksojmë që institucionet daneze e kanë vlerësuar pozitivisht trajtimin e të dënuarve në Kosovë dhe kapacitetet tona në këtë drejtim. Kjo është mundësi drejt një bashkëpunimi të afërt mes dy shteteve tona, duke thelluar partneritetin strategjik mes nesh. Nënshkrimi i letër-qëllimit, shprehja e vullnetit, mes të dyja palëve, do të arrihet ditën e hënë, gjegjësisht më 20 dhjetor të këtij viti pas vizitës së ministrave danezë në Republikën e Kosovës. Marrëveshja parashihet të gjejë zbatim të plotë në periudhën dhjetëvjeçare”, ka njoftuar Ministria e Drejtësisë.

Popullsia e burgjeve në Danimarkë është rritur për 19 për qind që nga viti 2015, duke arritur në më shumë se 4 000 të burgosur në fillim të vitit 2021, duke tejkaluar 100 për qind të kapacitetit sipas statistikave zyrtare.

Në të njëjtën periudhë, numri i gardianëve u turr për 18 për qind në këtë shtet skandinav me 5.8 milionë banorë, i cili njihet për burgjet e hapura për të burgosurit me dënime me më pak se pesë vjet. “Do të kemi mungesë



për deri në 1 000 vende në kapacitetet e burgjeve deri në vitin 2025”, ka thënë ministri i Drejtësisë së Danimarkës, Nick Haekkerup. Ai ka treguar se me marrëveshje është rënë dakord që

të merren me qira 300 burgje në Kosovë dhe të zgjerohet kapaciteti i burgjeve në Danimarkë për disa qindra vende.

Kosova kishte 1 642 të burgosur në vitin 2020, përkatësisht 97 për

qind të kapacitetit të saj, sipas Raportit Botëror të Burgjeve të Universitetit të Londrës.

Më parë Norvegjia dhe Belgjika kanë marrë me qira qeli burgu në Holandë.

Kurti: Qeveria do t'i trajtojë të gjitha problemet në fushën e energjisë

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Kryeministri Albin Kurti ka thënë se qeveria të cilën e udhëheq do t'i trajtojë të gjitha problemet në fushën e energjisë brenda këtij mandati. “Strategjia që pres ta paraqes para jush brenda gjysmëvitit të parë të 2022-s është vetëm hapi i parë në këtë drejtim. Unë zotohem për siguri të furnizimit, me tranzicion të qëndrueshëm me çmime të përbalueshme”, ka thënë ai.

Kurti ka thënë se Evropa po përballet me çmime rekorde të energjisë, të shtyra në masë të madhe globalisht nga çmimet

shumë të larta të furnizimit me gaz. “Ne kemi pasur fatin që kemi mundur të mbulojmë një sasi të konsiderueshme të kërkesës së brendshme nëpërmjet Termocentraleve Kosova A dhe Kosova B. Një pjesë tjetër mbulohet nëpërmjet burimeve të ripërtërishme”, tha kryeministri në hapje të konferencës. Megjithatë, në periudhën e dimrit, me ftohjen e motit rritet kërkesa për energji elektrike, kryesisht shkak i ngrohjes. “Si rezultat, kapacitetet gjeneruese nga termocentralet tona janë të pamjaftueshme për ta mbuluar kërkesën në kohët e pikut, dhe Kosova varet nga importet për t'i mbajtur dritat ndezur për të gjithë

gjatë gjithë kohës”, ka pohuar Kurti.

Kryeministri ka theksuar se energjia e tregtuar për ta mbuluar kërkesën në Kosovë tani blihet me çmime aq të larta (deri në 7 herë me çmimin e shitjes më shtrenjtë), sa që ka rrezikuar aftësinë financiare të furnizuesit publik dhe të gjitha ndërmarrjet e zinxhirit energjetik për ta garantuar sigurinë e furnizimit.

Kryeministri Kurti ka thënë se është e rëndësishme që tani të mundohemi ta kursejmë energjinë elektrike maksimalisht. “Megjithatë, tani na duhet që së bashku ta tejkalojmë dimrin e krizës së madhe të energjisë”, ka thënë kryeministri Kurti.

Tetë raste të reja me Covid në Kosovë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar të enjten se, sipas të dhënave nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës, nga 1 895 testime, tetë qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19.

Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes.

Të enjten janë shënuar edhe tetë

qytetarë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve është 157 933.

Në total numri i rasteve aktive është 314.

Në 24 orët e fundit janë dhënë 1 760 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 650 004 doza të vaksinës.

Deri më sot 775 162 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.

Bazuar në raportet e datës 16

dhjetor 2021 të Shërbimit Spitalor dhe Klinik dhe Universitar të Kosovës në trajtim janë 36 pacientë që po trajtohen në klinikat dhe repartet Covid-19.

Tetë pacientë janë të konfirmuar me Covid-19 pozitivë dhe 28 të tjerë post-Covid.

Nga numri i përgjithshëm i pacientëve, 11 pacientë janë me oksigjeno-terapi, kurse në Mjekimin Intensiv të Klinikës Infektive nuk ka pacientë.



Edhe uji pritet të shtrenjtohet

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Derisa autoritetet në Kosovë paralajmërojnë rritje të çmimit të ujit, një sasi e madhe e ujit të prodhuar për pije nuk arrin të faturohet fare.

Rritja e paralajmëruar e çmimit, megjithatë, nuk lidhet me sasi të humbura, por me rritjen e çmimeve të prodhimeve të tjera bazike.

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit në Kosovë (ARRU) tha se gjatë këtij viti janë prodhuar mbi 152 milionë metra kub ujë. Nga kjo sasi janë faturuar apo shitur rreth 68 milionë metra kub, në vlerë prej 25 milionë eurosh. Sasia e ujit të pafaturuar është 84 milionë metra kub.

Sipas raportit vjetor të ARRU-së, uji humbet për shkak të infrastrukturës së vjetër, dëmtimeve nga punimet në infrastrukturën rrugore dhe lidhjet e paligjshme.

Uji i humbur thuhet se ndikon drejtpërdrejt në mbulimin e kostos dhe fitimet e operatorëve shpërndarës të ujit. Në Kosovë operojnë shtatë kompani rajonale të ujit, të cilat i furnizojnë qytetarët me ujë të pijshëm.

Për Çaus Bajrushin, i cili ka punuar në Kompaninë Rajonale të Ujësllësit "Prishtina" dhe tani është në pension, humbja e ujit është një gjë e pakuptueshme. Sipas tij, problemi më i madh në industrinë e shërbimeve të ujit, gjatë dy dekadave të fundit, është lidhja ilegale e qytetarëve në sistemin e ujësllësit. "Përveç infrastrukturës së vjetruar, mbi 25 për qind në këtë sistem janë kyçe ilegale. Lufta e institucioneve duhet të jetë tek identifikimi i personave të lidhur në mënyrë joligjore dhe të merren masa ndaj tyre", ka thënë

Bajrushin.

Ilir Abdullahu, profesor i Lëndës së Hidraulikës, Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Kolegjin privat UBT në Prishtinë, thotë se eliminimi i tërësishëm i humbjeve të ujit është i vështirë por, megjithatë, institucionet e nivelit lokal dhe atij qendror "duhet të bëjnë më shumë" në këtë drejtim. "Duhet të investohet në rrjetet e amortizuara, në ujëmatës të rinj, kurse të humbjet komerciale duhet të ketë një kontroll shumë më të ashpër, që uji i pijshëm të mos keqpërdoret për nevoja të tjera. Që nga përfundimi i luftës [më 1999] uji i pijes përdoret qoftë në toka bujqësore, qoftë në kopshte, në rrugë. Nga muaji maj e deri në muajin shtator shihet se keqpërdoret. Për shkak të kyçjeve ilegale, kompanitë rajonale operojnë me këtë shkallë të humbjes së ujit", ka deklaruar Abdullahu për "Radion Evropa e Lirë".

Barra e humbjeve nuk duhet t'u ngarkohet qytetarëve

Për t'i mbuluar humbjet nga uji i pafaturuar, kompanitë rajonale kërkojnë rritjen e tarifave të ujit, thotë Bajrushin por, sipas tij, barra e humbjeve nuk duhet bartur te qytetarët. "Nuk është arsye që për shkak të humbjeve të ujit, t'i rritin tarifën në kurriz të qytetarëve, për t'i mbuluar shpenzimet e tyre financiare", ka thënë Bajrushin.

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit është institucioni përgjegjës për caktimin e tarifave të shërbimeve të ujësllësit. Zyrtarë të këtij institucioni thonë për "Radion Evropa e Lirë" se çmimi për një metër kub ujë ka mundësi të rritet për 1 ose 2 centë. Për



konsumatorët shtëpiakë tarifën aktuale për shërbimet e ujësllësit për një metër kub ujë janë 0.43 euro, kurse për konsumatorët komercialë dhe institucionale 0.69 euro.

Sipas zyrtarëve të ARRU-së, rritja eventuale e çmimit nuk bëhet për shkak të humbjeve të ujit, por konsiston me rritjen e çmimeve të produkteve bazike, siç janë energjia elektrike dhe derivatet. "Duke ditur se për ta dërguar ujin e trajtuar deri te konsumatori final nevojitet energji elektrike e konsiderueshme, këto shpenzime kanë ndikim direkt edhe në lartësinë e tarifave", thuhet në deklaratën e ARRU-së dhënë "Radion Evropa e Lirë".

Disa qytetarë të anketuar në Prishtinë shprehën të shqetësuar me mundësinë e rritjes së tarifave të ujit, në kohën kur në Kosovë kanë pësuar rritje çmimit e shumë prodhimeve ushqimore dhe ndërtimore. Zyrtarët kanë paralajmëruar rritje edhe të çmimit të rrymës

deri në 7 për qind. "Uji është produkt elementar dhe një rritje e çmimit nuk do të duhej të ndodhte", ka theksuar Idriz Bërbatovci, punonjës në Korporatën Energjetike të Kosovës. "Në familjen time pesëanëtarëshe, fatura e ujit vjen nga 18-19 euro. Kjo vlerë është e lartë, kur merren parasysh edhe shërbimet e tjera dhe gjërat e nevojshme për jetë. Në Korporatën Energjetike të Kosovës pagat janë pak më dinjitoze, por paramendojeni një faturë të tillë për familjet me asistencë sociale apo për punonjësit në sektorin privat. Kjo rritje nuk duhet të ndodhë", është shprehur Bërbatovci. Blerina Sinani, punonjëse në një kompani private në Prishtinë, thotë se Qeveria e Kosovës nuk duhet ta lejojë rritjen e tarifave të ujit. Sipas saj, Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit është ndërmarrje publike, andaj "nevojitet ndërhyja e qeverisë". "Sinqerisht, pres ndërhyrjen e

qeverisë në këtë situatë. Sepse, nëse edhe tarifën e ujit të pijshëm rriten, pas ngritjes së çmimeve të artikujve të tjerë, nuk e di se si do t'i përballojmë shpenzimet mujore si familje, me pagat që i marrim", ka deklaruar Sinani.

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, një qytetar shpenzon rreth 90 litra ujë në ditë.

Në Kosovë, 78 për qind e popullatës furnizohet me ujë të pijshëm përmes sistemeve publike të menaxhuara nga kompanitë rajonale të ujësllësit. Qytetarët e Kosovës furnizohen nga disa burime natyrore dhe artificiale të ujërave. Liqeni i Ujmanit në Zubin Potok, Batllava në Podujevë, Badoci në Prishtinë, Radoniqi në Gjakovë dhe Përlepnica në Gjiçan, krahas lumenjve Drini i Bardhë në Rrafshin e Dukagjinit, Ibri në Mitrovicë, Morava e Binçës në Anamoravë dhe Lepenci në jug, janë disa prej burimeve kryesore të ujit të pijshëm në Kosovë.

Rikthehet ngrohja nga 'Termokos'-i

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ka njoftuar se është lëshuar në punë njësi B1 e termocentralit 'Kosova B' dhe furnizimi me ngrohje qendrore për konsumatorët e Prishtinës. "Si rrjedhojë, sot në mëngjes, më 16 dhjetor, në orën 08:10, 'Termokos'-i ka filluar të furnizohet me energji termike (me avull) nga Kosova B për ngrohje qendrore të qytetit të Prishtinës", thuhet në komunikatën për medie të KEK-ut.

Edhe Ndërmarrja Publike "Termokos" njofton se ka filluar furnizimi me ngrohje. "Në orët e hershme të mëngjesit kemi filluar ta marrim avullin nga KEK-u, si rrjedhojë tashmë ka filluar edhe prodhimi i energjisë

termike. Kjo do ta mundësojë vazhdimin e furnizimit me ngrohje të mjaftueshme, gjë që nënkupton ndërprerjen e furnizimit nëpërmes kaldajave me mazut", thuhet në njoftimin për medie të kësaj ndërmarrje.

'Termokos'-i të mërkurën pati ndërprerje ngrohjen për të gjithë konsumatorët në Prishtinë për shkak të pamundësisë për t'u furnizuar me avull nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) pas problemeve në njësinë B1 të termocentralit 'Kosova B'. Ministri e Ekonomisë e Kosovës, Artane Rizvanolli, tashmë ka paralajmëruar gjendje të jashtëzakonshme të furnizimit me energji elektrike në vend për shkak të çmimeve të larta të importit.

Duke raportuar në Komisionin Parlamentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, Rizvanolli ka thënë se situata




është pasojë e çmimeve të larta të importit nga shtetet e tjera. Kriza energjetike në botë ka nisur tash e sa muaj, kryesisht

për shkak të mungesave të gazit dhe rritjes së çmimeve të gazit. Sipas njoftimit, deri në orët e mesditës së të enjtes pritet

stabilizimi i plotë i furnizimit me ngrohje të mjaftueshme dhe cilësore për të gjithë konsumatorët.

Një histori e shkurtër



Nga: Ernest HEMINGWAY
Përktheu: Fasli HALITI

Në Padovë, një mbrëmje shumë të ngrohtë e hipën mbi çati, dhe ai mundi ta shihte qytetin nga lart. Qielli ishte plot i dallandyshe. Pas pak u bë errësirë dhe u shfaqën reflektorët. Të tjerët zbritën duke marrë me vete shishet. Ai dhe Luz mund të dëgjonin, më poshtë, në ballkon.

Luci u ul në krevat. Ai ishte i freskët dhe të gjallë në natën e nxehtë. Për tre muaj rresht Luz bëri turnin e natës. Ia linin ta bënte me dëshirën e vet. Kur e operuan, ai ai e përgatiti atë për tavolinën kirurgjike; dhe bënë një lojë fjalësh klizme dhe snajper.

Ai shkoi nën anestezi duke ndenjur më i qetë sesa mundej, sepse nuk donte që t'i shpëronte

ndonjë gjë në çastin kur dërdëllitet blabla. Kur ai filloi të eci me paterica, shkante për të matur temperaturat d, kështu Luz nuk duhej të çohet nga krevati. Ishin vetëm tre apo katër pacientë, dhe e dinin të gjithë. Luci iu dukej simpatike të gjithëve. Ndërsa kthehej prapa gjatë korsive, ai mendonte për Lucien që e priste në shtratin e saj.

Para se ai të kthehej në front, u futën të dy në katedrale që të luteshin. Katedralja ishte errët dhe e qetë, dhe kishte njerëz të tjerë që luteshin. Donin të martohej, por nuk kishte kohë për për dokumentacionet, dhe asnjë prej të dyve nuk kishte certifikatën e lindjes. Ata e ndjenin veten si të martuar tashmë, por donin që ta dinin të gjithë, kështu që nuk do të rrezikonin të humbisnin atë çka kishin mes tyre.

Lusi i shkroi shumë letra të cilat ai i mori pas armëpushimit. Në front arritën pesëmbëdhjetë letra, të gjitha së bashku, dhe ai i rënditi sipas datave dhe i lexoi të gjitha me radhë. Të gjitha flisnin për spitalin, dhe se sa e donte ajo atë, dhe sa e pamundur ishte që të rrinte pa të, dhe sa e tmerrshme ishte mungesa e tij gjatë natës.

Pas armëpushimit vendosën së bashku se ai do të kthehej në shtëpi për të kërkuar një punë me qëllim që të mund të mund të martohej. Luci nuk do të nisej gjersa ai nuk do të kishte gjetur një punë të mirë dhe s'do të mund të vinte që ta merrte me vete ë Nju Jork.

Ishte e kuptueshme që s'do ta kishte ngritur bërrylin lart, dhe ai nuk kishte asnjë dëshirë që të shihte miqtë e tij ose njerëzit e tjerë në Shtetet e Bashkuara. Donte vetëm të gjente një punë

dhe të martohej. Në trenin që i sillte nga Padova në Milano, ata u grindën sepse Lucia nuk ishte e gatshme të shkante menjëherë në Amerikë me të. Kur u deshën të përshëndeteshin në stacionin e Milanos, u përshëndetën me një puthje, por nuk kishin pushuar së grinduri.

Ai mbeti shumë i hidhëruar, për faktin pse u përshëndetën kështu me njeri -tjetrin.

Ai shkoi në Amerikë mbi një anije që nisej nga Gjenova. Luci u kthye në Pordenone për të hapur atje një spital. Ishte një vend shirash dhe i vetmuar, dhe ndodhej aty një batalion guximtarësh, me seli në qytet. Ndërsa kalonte dimri në atë qytet të lagësht dhe i përbaltur, major i batalionit bëri dashuri me Lucien, dhe ajo që s'kishte njohur kurrë italianë, më në fund i shkroi atij në Shtetet e Bashkuara me qëllim që t'i

thoshte se ajo e tyrja ishte thjesht një gjë fëmijërore I vinte keq, dhe e dinte se mbase ai nuk do të arrinte ta kuptonte, por mbase një ditë do ta falte, dhe do t'i ishte mirënjohës. Parashikonte, gjithçka, krejt papritur, të martohej në pranverë. E donte si gjithmonë, por tani ai e kuptonte se ishte vetëm një dashuri adoleshentësh. Ajo shpresonte që ai të bënte një karrierë të madhe, dhe kishte një besim të verbër të pakushtëzuar në të. E dinte se ishte vendimi më i mençur.

Majori nuk u martua me të as në pranverë e as në një stinë tjetër të vitit. Luci nuk mori asnjëherë ndonjë përgjigje për letrën që kishte dërguar në Çikago. Kohë më vonë, ai mori drenazhimin nga një shitësi i një dyqani i Loop ndërsa kalonin me taksi Parkun Lincoln.

Nicole Kidman do të nderohet me çmim special për arritje në karrierë

Organizatorët njoftuan në një deklaratë për shtyp se aktorja e njohur Nicole Kidman, do të marrë Çmimin e Arritjes në Karrierë për performancën e saj në "Being the Ricardos" në festivalin e filmit që do të mbahet në janar të vitit 2022. Çmimet Ndërkombëtare të Filmit Palm Springs do të zhvillohen më 6 janar në Palm Springs Convention

Center në Kaliforni, ndërkaq festivali pritet të zgjasë deri më 17 janar.

Kidman luan Lucille Ball në "Being the Ricardos", i cili ndjek uljet dhe ngritjet në jetën personale dhe profesionale të Ball (Kidman) dhe burrit të saj, Desi Arnaz (Javier Bardem), gjatë një jave.

"Në televizionin amerikan ka

pak yje klasie më të dashur se Lucille Ball. Duke u përballur me sfidën për të luajtur një talent të tillë ikonik, Nicole Kidman jep një performancë të vërtetë të drejtpërdrejtë në kapjen e kohës komike në kamera dhe guximin jashtë kamerës e bëri Lucy një forcë të pandalshme në vitet 1950 dhe 1960", tha kryetari i festivalit Harold Matzner.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Kosova në grup me Greqinë, Irlandën e Veriut dhe Qipron ose Estoninë



NYON, 16 DHJETOR - Sot në selinë e UEFA-s në Nyon është bërë tërheqja e shortit për edicionin e tretë të Ligës së Kombeve. Goglat e shortit edhe një herë e vendosen Kosovën në grup me Greqinë, ekip me të cilin është përballur edhe në edicionin e kaluar të kësaj gare, por edhe në eliminatorët e fundit të Botërorit 2022. "Dardanët" janë përfshirë në Grupin 2 të Ligës C, ku krahas Greqisë janë edhe Irlanda e Veriut, si dhe fituesi i ndeshjes Qipro-Estoni. Këto dy të fundit do të luajnë në ndeshjen e "play-

aut"-it për t'u përcaktuar se cila do të mbetet pjesë e Ligës C, e cila do të bie në Ligën D. Presidenti Agim Ademi pas tërheqjes së shortit është prononcuar për faqen zyrtare, teksa e ka vlerësuar grupin e "dardanëve" si pozitiv dhe mundësi për t'i treguar vlerat tona në Ligën C. "Mund të them se ishte një short jo i lehtë për ne, pasi kemi të bëjmë me ekipe që gëzojnë respekt në futbollin evropian. Sidoqoftë, ndoshta është mirë që shmangëm disa prej kombëtareve të papërshtatshme. Grupi është goxha i nivelizuar, pa marrë

parasysh se nga cilat vazo vijnë kundërshtarët. Greqinë e njohim tashmë shumë mirë, ngase kemi katër ndeshje kundër tyre, derisa me ekipet tjera do të përballemi për herë të parë. Unë kam besim në djemtë tanë dardanë dhe besoj në forcën e ekipit. Me ndihmën e tifozëve jam optimist se Kosova në fund të këtij edicioni të Ligës së Kombeve do të jetë e para në Grupin 2 të Ligës C", ka thënë presidenti Ademi. Ndeshjet e këtij edicioni në Ligën e Kombeve do të zhvillohen në qershor dhe shtator të vitit të ardhshëm.

SHKURT

Garibay përforcon KB Peja, largohet Smith

KB Peja ka arritur marrëveshje transferimi me reprezentuesin meksikan Edgar Garibay. Lajmi është bërë me dije nga drejtori sportiv i klubit pejan Arbër Elshani përmes një postimi në rrjetin social "Facebook". Edgar Garibay është pjesë e Kombëtares së Meksikës. Ai është 31-vjeçar dhe pozita e tij është si qendër. Garibay është i gjatë 211 cm. "Edgar Garibay, reprezentues i Kombëtares së Meksikës, është lojtari i ri i KB Peja", ka shkruar Elshani. Ndërsa nga skuadra e Pejës është larguar Jyles Smith. Arbër Elshani ka njoftuar se shkëputja e kontratës me Smithin është bërë me marrëveshje të dyanshme. Smithi do të largohet nga klubi pejan më 19 dhjetor.

Kosova merr pjesë në Kampionatin Shqiptar të skive

Përfaqësuesja e Kosovës në skijim është duke qëndruar në Itali, ku do të marrë pjesë në garën e parë ndërkombëtare të organizuar nga Federata Shqiptare e Skijimit "Kampionati Shqiptar i Skive", me datat 18-21 dhjetor 2021 në disiplinën e Sllallomit dhe Sllallomit të Madh. Në këtë garë do të marrin pjesë: Kiana Kryeziu dhe Era Deva marrin pjesë në kategorinë e femrave, kurse Albin Tahiri, Arbi Pupovci, Drin Kokaj dhe Dren Spahiu te meshkujt. Në këtë garë Kiana Kryeziu do të luftojë për t'i arritur pikët olimpikë për pjesëmarrje në lojërat olimpikë dimërore "Pekin 2022".

Steve McKenna: Do ta mposht Markun përpara shqiptarëve

Boksieri 24-vjeçar nga Irlanda, Steve McKenna, ka sfiduar hapur luftëtarin tonë Florian Marku. Në një video të postuar në TikTok, McKenna i bën thirrje Markut se nuk ka shpëtim. Irlandezi ka dhjetë ndeshje si profesionist dhe të dhjeta i ka të fituara. Nga këto dhjetë fitore, gjashtë i ka me KO. Fjalët e McKenna drejtuar Markut: "Florian Marku, mjaft u fshehe! Unë jam këtu duke të të pritur. Do të ndeshem me ty në çdo kohë, në çdo vend, kudo që ti të duash. Do të vij në Shqipëri dhe do të të grushtoj në vendin tënd përpara të gjithë shqiptarëve. Le ta bëjmë këtë gjë".

Khaka: Fitore e madhe, paraqitje madhështore

LONDËR, 16 DHJETOR - Granit Khaka e ka përshkruar si madhështore paraqitjen e Arsenalit në fitoren 2:0 kundër West Hamit të mërkurën në Premierligë. Mesfushori shqiptar i Zvicrës luajti 90 minuta të plotë për t'i ndihmuar Arsenalit ta mposhtë rivalin londinez dhe ta kalojë në vendin e katërt në tabelë. Gabriele Martinelli e kaloi Arsenalin në epërsi në

minutën e 48, para se Smith Rowe ta dyfishonte epërsinë dhe ta vuloste fitoren e skuadrës së Mikel Artetës në minutën e 87. West Ham luajti me një lojtar më pak për pjesën më të madhe të pjesës së dytë, pas përjashtimit nga fusha të Coufal me kartonin e dytë të verdhë në minutën e 67. Khaka, i cili ka vuajtur nga një lëndim në gju këtë sezon, e quajti të madhe fitoren në

"Emirates". "Fitore e madhe, paraqitje e madhe, përkrahje e madhe", ka shkruar Khaka në "Instagram". Khaka i ka bërë vetëm tetë paraqitje në të gjitha garat këtë sezon dhe ende është në kërkim të golit të parë sezonal. Ai mungoi tetë ndeshje shkaku i lëndimit të ligamentit të gjurit dhe dy ndeshje të tjera ishte i pezulluar pas kartonit të kuq.



Antetokounmpo infektohet me Covid

MILWAUKEE, 16 DHJETOR - Giannis Antetokounmpo nuk do të luajë kundër Indiana Pacers dhe mund ta humbasë spektaklin e Krishtlindjeve kundër Boston Celtikut.

Basketbollisti grek duhet t'u nënshtrohet protokolleve të NBA-së, pasi ka rezultuar pozitiv me Covid-19. Kampioni aktual në fuqi do të jetë gjithashtu pa Uesli Metjus dhe

Donte Di Vinçenzo. Antetokounmpo luajti të dielën në Nju-Jork dhe të hënën në Boston. Ai regjistroi një "triple-double" në fitoren në "Madison Square Garden" dhe shënoi 20

pikë në humbjen ndaj Bostonit. Ylli i Milwaukee Bucks duhet të ketë dy teste negative PCR para se të kthehet në ekip, pasi duhet të kalojë dhjetë ditë në izolim.



Mbappe, rrëfim ndryshe: Përvoja jetësore vlen më shumë se paratë

PARIS, 16 DHJETOR - Kylian Mbappe ka dhënë një intervistë të gjatë për "Paris Match" këtë të enjte. "Lidhjet njerëzore janë shumë më magjepsëse se paratë", shpjegon ylli i PSG-së dhe kombëtares franceze. "Kam marrë mësim të dobishme në karrierën e deritanishme". Ylli francez së shpejti do të mbushë 23 vjeç. "Është përvoja e jetës ajo që ka rëndësi, më shumë se të fitosh para, edhe nëse financat janë të rëndësishme, sepse kemi familje për të mbajtur. Unë jam i etur, mbi të gjitha, për zbulime, udhëtime, takime me lojtarë, kultura të ndryshme...". Sulmuesi nuk e përmend në intervistë transferimin e munguar të verës te Real Madridi apo të ardhmen e tij: "Ishte pak e vështirë në fillim të konsiderohesha një xhevahir... Fatmirësisht, prindërit e mi nuk më lanë të shpërqendrohesha nga shumata e parave. Dhe ata bënë mirë, ditën të edukojnë një fëmijë 14-vjeçar, pasi i kishin thënë se vlen miliona euro. Falë kësaj kam një marrëdhënie të qetë me paratë. E di që janë të



rëndësishme, jam i lumtur që i kam, por kjo nuk është ajo që më shtyn çdo sekondë të ditës. Dua të mbetem njeri i përrulur, pavarësisht statusit që kam tashmë si futbollist. Unë e vlerësoj shumë sinjeritetin". Në nivelin strikt sportiv, Kylian Mbappe nuk mendon se yjet e shumtë të PSG-së janë të dëmshëm për kohezionin e ekipit. "Në grupin tonë kemi shumë yje dhe rezultati është aty. Ne po fitojmë tituj,

Sigurisht, duhet të pranosh të bësh lëshime kur nuk je i vetmi yll, por nuk mendoj se kjo është një gjë e keqe, përkundrazi", siguron lojtari që përbën "MNM" me Lionel Messin dhe Neymarin. I kurorëzuar kampion bote me Francën në vitin 2018, Mbappé beson se ka arritur "ëndrrën e tij më të madhe": "Ta fitosh për herë të dytë radhazi Botërorin do të ishte e jashtëzakonshme!".

Mercedesi heq dorë nga ankesa ligjore kundër triumfit të Verstappenit

SHTUTTGART, 16 DHJETOR - Mercedesi ka vendosur të mos ankojë kundër rezultatit të garës së Grand Prix në Abu Dhabi, i cili e shpalli Max Verstappenin kampion të botës në Formula 1. Vendimi i Mercedesit vjen pasi organi qeverisës FIA vendosi të kryejë një analizë të hollësishme të garës së Abu Dhabit. Po ashtu, Mercedesi vendosi të tërhiqej sepse, siç ka thënë, nuk donte ta njolloshte imazhin e Formulës 1. Verstappenin i Red Bullit e tejkaloi Hamiltonin e Lewis Mercedesit në rrethin e fundit të garës për ta fituar titullin e parë të botës. Zyrtarët e Formulës 1 ia hodhën poshtë dy ankesa Mercedesit të dielën, ekipi i të cilit u ankua se drejtori i garës Michael Masi nuk i kishte zbatuar rregullat siç duhet. Australiani nuk e kishte ndjekur protokollin e zakonshëm për rifillimin e garës pas futjes së makinës së sigurisë në shteg. Vendimi i tij e la Hamiltonin, i cili



po udhëhiqte gjatë shumicës së garës dhe ishte në rrugë për ta fituar titullin e botës, me goma të vjetra në makinë, me Verstappenin pas tij me goma të reja. Mercedesi tha se është në bisedime konstruktive me FIA-në që prej ditës së garës, në përpjekje për të krijuar sqarime për të

ardhmen. Në një komunikatë të gjatë për medie, Mercedesi i ofroi urime Verstappenit dhe Red Bullit. "Dëshirojmë t'ju shprehim nderimet tona të sinqerta për arritjet tuaja këtë sezon. Ju e bëtë vërtet epike luftën për titull të kampionit në Formula 1".

SHKURT

Rahoveci fiton ndeshjen e fundit të stinorit vjeshtor

Zhegra dhe Rahoveci janë takuar të mërkurën në Gjilan, në ndeshjen e fundit të stinorit vjeshtor në Superligën e Kosovës në hendboll. Rahoveci ka shënuar fitore me rezultatin 30:23. Ishte kjo ndeshja përmbyllëse e xhiros së 14-t, që është e fundit për këtë vit. Pjesën e parë të kampionatit Rahoveci e ka përfunduar në pozitën e katërt me 18 pikë të mbledhura, ndërsa Zhegra është e nënta me 2 pikë. Alban Haziri ishte më efikas te Rahoveci me 9 gola. 6 i realizoi Arlind Tanushi. Landrit Mustafi shënoi 6 gola për Zhegrën, ndërsa 5 i shtoi Elion Goqi.

Pogba, afër largimit nga Unitedi

Paul Pogba është gati të largohet nga Manchester Unitedi pasi ky i fundit po mendon ta përforcojë mesfushën. 28-vjeçari ka kontratë me "Djajtë e Kuq" edhe gjashtë muaj e, si duket, rinovimi nuk është në planet e tyre. Pogba mund të largohet gjatë verës si agent i lirë te Real Madridi ose PSG-ja pasi, sipas raportimit të "Daily Telegraph", të dyja skuadrat kanë shfaqur interesim. Francezi u transferua në "Old Trafford" në vitin 2016 për 89 milionë funte. Disa nga zëvendësuesit e Pogbas pritet të jenë Boubacar Kamara, John McGinn, Amadou Haidara dhe Christopher Nkunku.

De Jongu kushton 90 milionë euro

Barcelona e ka vendosur çmimin e mesfushorit holandez Frenkie de Jong i cili mund të largohet nga "Camp Nou". Mediumi "Fichajes" raporton se "Blaugrana" e vlerëson ish-futbollistin e Ajaxit 90 milionë euro. Pra, nëse një klub është i gatshëm ta paguajë këtë shifër, mund ta bënte të vetin përfaqësuesin holandez. Interesim për mesfushorin kanë treguar Bayern Muncheni dhe Liverpuli.

Interi dhe Barça planifikojnë shkëmbim e Sanchezit me De Jongun

Aksi Milano - Barcelonë është më i nxehtë se kurrë. Nuk bëhet fjalë për fushën e lojës, por për merkato. Interi dhe Barcelona janë gati që të bëjnë një shkëmbim të bujshëm mes tyre. Sipas prestigjiozes spanjolle "AS", të dyja ekipet janë gati ta shkëmbejnë sulmuesin Aleksis Sanchez me Luk de Jong. Holandezi nuk pëlqehet nga Xavi dhe po sheh një skuadër për të pasur sa më shumë minuta në këmbë. Sanchez shihet si opion i mirë duke qenë se ka luajtur më parë me spanjollët. Problem mbetet Sevilla e cila zotëron kartonin e De Jongut. Operacioni do të jetë një huazim i thjeshtë deri në fund të sezonit.

Edhe pesë lojtarë të Realit rezultojnë pozitivë me Covid

Rastet me Covid-19 te Real Madridi janë shtuar. Dje klubi madrilen përmes një komunikate zyrtare ka konfirmuar se dyshja Luka

Modriq dhe Marcelo kanë dalë pozitivë me koronavirus. Por, këto, mesa duket, nuk janë rastet e vetme në skuadër, me

"Vozpopuli" që raporton se edhe pesë lojtarë të tjerë kanë dalë pozitivë në analizat e Covid-19. "Burimet e gazetës na kanë

siguruar se edhe pesë lojtarë të tjerë janë infektuar", shkroi gazeta spanjolle. Ndërkohë, Real Madridi ndeshjen e radhës e zhvillon

si vendas ndaj Cadizit, por në rast që konfirmohen rastet, atëherë ekziston mundësia që ta shtyjnë takimin.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

